REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 766119
Date/Datum 18.11.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit: **KK Suhareke** OE ankues: **"N.N.T "ETNIKU"- Suhareke**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP 766/19
Prej:	Es'heme Beka – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 766/19 të parashtruar nga OE "**N.N.T "ETNIKU" - Suhareke**		
Datë	18.11.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës: 30.10.2019, me nr. 766/19 të parashtruar nga OE "**N.N.T "ETNIKU"- Suhareke**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Asfaltimi i rruges qe lidhe fshatin Ngucat (Rruga BashkimGashi)-Lagjja Zekolli, Suhareke", me nr.prok: 624-19-6384-5-1-1** inicivar nga **AK — "KK Suhareke"**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KK Suhareke.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - N.N.T "ETNIKU.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		05.11.2019	**18.05.2019**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të ekspertit.*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 30.10.2019, OE "N.N.T "Etniku"- Suhareke,, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë OE " N.N.T VEHA & € EURO GROUP SH.P.K "- Suhareke, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Asfaltimi i rruges qe lidhe fshatin Ngucat (Rruga Bashkim Gashi)-Lagjja Zekolli, Suhareke"**, me nr.prok: 624-19-6384-5-1-1 inicivar nga AK — "KK Suhareke"

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues "N.N.T "Etniku"- Suhareke.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues N.N.T "Etniku"- Suhareke, janë:
Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 57 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Autoriteti kontraltues e ka rekomanduar për kontratë grupin e operatorëve ekonomik " N.N.T Veha & € Euro Group Sh.P.K " ndërsa i njejti grup i papergjegjshëm me arsyet si në vijim:

Veha Group është i papërgjegjshëm, sepse në FDT është kërkuar Inxhinier i dip, i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose master drejtimi konstruktivë, me se paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit dhe të jetë i certifikuar me IWS ose ekuivalente, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi se inxhinieri i ndërtimtarisë është i certifkuar me IWS.

Ju sqarojmë se OE te rekomanduar për kontratë ka oftuar një lloj çertifikate vendore e lëshuar nga konpani private e cila nuk është sipas kerkesës së AK-së sepse kjo licencë nuk është çertifikatë e njohur ndërkmbëtarisht.

1. Marreveshja mes OE të rekomanduar për kontratë me Celi AG nuk specifikohet për të cilin projekt, ndërsa Ngarkuesi 24 ton DUD nuk shihet fare dhe dyshojmë se nuk është ne emër të Euro Bag, prej të cilit është blerë kjo pajisje, prandaj kërkojmë të vertetohet ky fakt.

3, Grejderi marrëveshja me Hidrotern data 06.04.2018 dhe nuk specifikohet për të cilin projekt i duhet

4, Marrëveshja me Deferi-CO nuk specifikohet për cilin projekt.

5, Marrëveshja e OE Veha për shfrytëzim të pajisjeve është me konpaninë Seferi CO. Ndërsa në duda doganor dhe në dëshmi tjera figurojmë së këto pajisje janë në emer të I Seferit, të cilat kompani janë të ndara dhe funksionojnë në menyrë të pavarur, kurse nuk është ofruar asnjë dëshmi se cilat pajisje i ka në pronësi SEFERI-CO.

Gjithashtu Seferi-CO është pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, prandaj për këtë arsye duhet të shpallet i papergjegjshëm nga ana e autoritetit kontraktues, OE i rekomanduar për kontratë dhe OE Seferi Co.

6, Marrëveshja me 9 Vëllëzerit nuk specifikohet për të cilin projekt dhe nuk është bërë me liderin e konzorciumit VEHA sipas të cilit është obliguar të bëhet marrëveshja si lider i projektit. Anëtari i knzorciumit EuroGroup ka nënshkruar marrëveshje për shfrytëzim të mjeteve me kompaninë 9 Vëllezërit, prandaj OE i rekomanduar për kontratë duhet të shpallet i papergjegjshëm.

7. Nuk shihen qartë DUDA E 9 VËLLEZËRVE

8. Marrëveshja me Labi Petroll nuk specifikohet për cilin projekt

9. Marrëveshja për asfalt me I.Seferi shpk nuk specifikohet për cilin projekt

10. Marrëveshja me gurëthyesin Celi Ag nuk specifikohet për cilin projekt

Gjithashtu edhe deklaratat nën betim të dy anëtarëve të konzorciumit nuk janë të nënshkruara me dorë, por duket të jenë të manipuluara përmes skenimit.

Ndërsa rek kontrata e prezantuar me kompaninë " **Fati im** ", dyshojmë se nuk është e realizuar pasi që nuk ka asnjë transaksion bankar në lidhje me këtë projekt.

Po ashtu edhe tek kontrata me Limak nuk përputhen datat anglisht në pikën 2 shkruan data 01.10.2018, ndërsa turqisht pika 2 e kontratës shkruan data 01.10.2013 dhe në referencë nuk shkruan që punimet kanë përfunduar. Këto punime siç jemi në dijeni akoma vazhdojnë (https://www.facebook.com/SHPK-Eurogroup-349257248532921/)

OE i rekomanduar për kontratë ka të bashkangjitur edhe një kontratë e cila nuk mund të mirret si valide sepse është në vazhdim që titulohet "Ndërrimi i lagjes"SOFALIA HILLS" sipas Parimit çelësat në dorë".

Pra sipas të gjitha arsyeve të përmenduara me lartë OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat e FDT-së dhe njoftimi për kontratë dhe duhet shpallur si tenderues i eliminuar e jo të rekomanduar për kontratë, nga ana e autoritetit kontraktues.

Po ashtu edhe operatori ekonomik "**Am Group Shpk** " është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar deklaratën për specifikime teknike, e cila ka qenë kërkesë nga ana e autoritetit kontraktues.

Po ashtu ky OE nuk ka ofruar stafin sipas kërkesave të anëtarëve të konzurciumit dhe është i pa përgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat ashtu siç është kërkuar nga ana e AK-së në FDT dhe tek njoftimi për kontratë.

Ndërsa operatori ekonomik "NNT Burimi Fami-ing", është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar deklaratën për specifikime teknike, Menaxheri Inxh. Infrastrukt.dëshmia për 3 vitet përvojë pune i mungon, gjithashtu nuk ka IWS të çertifikuar dhe është e qëndrueshme arsyeja e eliminimit nga ana e autoritetit kontraktues për këtë OE, sepse i mungon edhe dëshmia për sigurimin e tenderit ashtu siç është kërkuar në FDT dhe nuk ka ofruar dëshmi për pikën " Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionaleStafi profesional siç është kërkuar në FDT" Pra ne pajtohemi me arsyen e AK-së për eliminimin e këtij operatori ekonomik.

Po ashtu edhe operatori ekonomik "NTP Bamirs EuroFamis", është i papërgjegjshëm sepse nuk ka oftuar deklarata për specifikime teknike.

Gjithashtu ky OE nuk posedon IWS për Inxhinierin e Ndërimit Konstruktiv gjë që është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktues në FDT tek kërkesat mbi mundësitë teknike/ose profesionale. Pra ky operator duhet shpallur i papërgjegjshëm ashtu siç e cekëm me lartë sepse nuk i plotëson kërkesat e lartëcekura.

Operatori ekonomik " **Victoria Invest Shpk** ". Gjithashtu edhe ky operator ekonomik duhet shpallur i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar deklaratë për specifikime teknike. Po ashtu nuk posedon edhe IWS të certifikatat për Inxhinierin e Ndërtimit Konstruktiv tek Kërkesat mbi mundësitë teknike/ose profesionale.

Gjithashtu operatorit në fjalë i mungon edhe fleta e dytë e sigurimit të tenderit. Pra nuk i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë dhe duhet shpallur si OE i papërgjegjshëm.

Gjithashtu edhe OE "**Seferi Co Shpk**" është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar sigurimin e tenderit, po ashtu është e qëndrueshme edhe arsyeja e eliminimit të këtij OE nga ana e AK-së sepse nuk ka ofruar dëshmi edhe për pikën Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale/Stafi profesional siç është kërkuar mbi FDT dhe po ashtu i mungojnë edhe dëshmitë e kërkuara në FDT për pajisje.

Po ashtu edhe OE " **Vëllezërit Hoxha**" është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar sigurimin e tenderit, po ashtu është e qëndrueshme edhe arsyeja e eliminimit të këtij OE nga ana e AK-së për shkak se, nuk i ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale/Stafi profesional siç është kërkuar me FDT.

Gjithashtu edhe " **Flori Shpk**", është i papërgjegjshëm sepse i mungon dëshmia për sigurimin e tenderit siç është kërkuar në FDT dhe nuk ka ofruar dëshmi për pikën.

Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale/Stafi profesional siç është kërkuar në FDT dhe po ashtu i mungojnë dëshmitë e kërkuara me FDT për pajisje. Pra janë të qëndrueshme arsyet e eliminimit nga ana e AK-së.

Në vendimin e AK-së të dt. 21.10.2019 për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsye faktike dhe ligjore për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim por vetëm e ka cilësuar si të pa bazuar.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e përmendura me lartë verejmë se asnjëri nga operatorët nuk i ka plotësuar kërkesat e FDT-së dhe njoftimi për kontratë dhe janë të papërgjegjshëm nga operatorët ekonomik të përmendur me lartë, dhe ju sqarojmë se ne jemi operatori i cili duhet të rekomandohemi për kontratë sepse plotësojmë të gjitha kërkesat ne FDT dhe tek nnjoftimi për kontratë.

Përfundimisht autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së , sepse ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëv nuk është bërë konform këtij neni, pasi që e kanë rekomanduar për kontratë, një OE i cili nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, kurse paragrafi 4 i nenit 59 të LPP-së e përshkruan qartë *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmeni me të gjitha kërkesat e parashikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk ka respektuar edhe kriterin kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm** me çmim më të ulët, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

AK-ja me këtë vlerësim dhe vendim na ka diskriminuar neve në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë, ndërsa ne jemi diskriminuar, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe kemi ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin me të ulët, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi, ndërsa në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së parashihet qartë " Autoriteti kopntraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në menyrë transparente".

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"N.N.T ETNIKU"**
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë proceduren ligjore në institucionet tjera kompetente.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë	**02.08.2019**
Lloji i procedurës së aplikuar	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar	Punë
Vlera e parashikuar e kontratës	**700.000,00€**
Kriteri për dhënie të kontratës	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave	**19.09.2019**
Data e hapjes së ofertave	**19.09.2019**
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave	**09.10.2019**
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar	**11.10.2019**
Data e vendimit të AK-së për dhënie të kontratës	**11.10.2019**
Data e kërkesës për rishqyrtim	**16.10.2019**
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim	**21.10.2019**

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa1- Operatori ekonomik duhe ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 Neni 65. Kërkesa2 -Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore, se ju nuk keni obligime borxhe te tatimeve në ATK. Vlefshmëria e vërtetimit duhet te jete maksimumi 90 dite nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes se ofertave. Vërtetimi kërkohet origjinal ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës Kërkesa3-OE duhet ta siguroje AK se kompania (biznesi) nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë me nje dokuemtn te lëshuar nga Gjykata kompetente.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia1- Deklarata nën betim e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes) Dëshmia2- Vërtetimi i ATK. Dëshmia3- Vërtetimi nga gjykata kompetente (Origjinal ose kopje e noterizuar nga noteri) Dëshmia4- Vërtetimi nga Komuna. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken 2,3 dhe 4, i jep te drejte Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.

Deshmia kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 180 dite nga data e lëshimit deri ne ditën e dhënies. Kërkesa4-OE duhet ta siguroje AK se ka kryer obligimet tatimore ndaj Komunes. Deshmia kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 90 dite nga data e lëshimit deri ne ditën e dhënies.	
Përshtatshmëria profesionale: **Kërkesa1-Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit (kopje) Kërkesa2-Çertifikata e Numrit Fiskal, nëse nuk është e përfshire ne certifikaten e biznesit (kopje) Kërkesa3-Çertifikata per Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK (kopje)**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia1- Çertifikata e regjistrimit te biznesit, se bashku me dokumentin Informatë mbi Bizneset (kopje). Dëshmia2- Çertifikata e numrit Fiskal nëse nuk është e përfshire ne certifikatën e biznesit (kopje). Dëshmia3- Çertifikata per Regjistrim në TVSH (kopje).**
Kapaciteti ekonomik dhe financiar: **3.Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare Kërkesa1-Operatori ekonomik duhet te ofrojë dëshmi të kënaqshëme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i Operatorit Ekonomik, ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate eshtë jo më pak se 1.400.000,00 euro.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia1-Dokument nga banka për qarkullimin e OE ose pasqyrat e auditura financiare, ose deklaratat vjetore tatimore te dorëzuara ne ATK.**
Kapaciteti teknik dhe professional: **Kërkesa1- Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme, ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne vlerën prej se paku 1.000.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit DHE dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve. Kërkesa2 - Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushen perkatese, se paku 2.1.Menaxher i projektit- Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi Infrastrukture rrugore ose master drejtimi Infrastrukture rrugore, me se paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit. 2.2.Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktive ose master drejtimi konstruktive, me se paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit dhe te jete i certifikuar me IWS ose ekuvalente. 2.3.Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Dëshmia1 -Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjajshme të realizuara ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, DHE dëshmitë e përfundimit Referenca t ose procesverbali et e pranimit teknik. Dëshmia2 - Kontratat e punës ose mareveshjet me inxhinierin/at, Diploma e NOTERIZUAR dhe nga një CV. Per stafin qe eshte kerkuar te jete i Licensuar te ofrohet edhe licensa. Dëshmia3 – Librezat kopje të pajisjeve ose Dokumentin doganor, kontratat faturat e blerjes së pajisjeve apo marëveshjet për shfrytëzimin e pajisjeve. Ne rastet kur OE ofron kontrata fatura te blerjes se pajisjeve apo mareveshjeve per shfrytezimin e tyre, pajisjet duhet te deshmohen me kopjen e librezave ose dokumentin doganor (DUD). Dëshmia4- Certifikatat ISO te noterizuara. Dëshmia5- Kopja e licences se vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale (nese ka mareveshje me OE te licensuar duhet te prezentoje edhe mareveshjen). Dëshmia 6 - Kopja e licences se vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për**

me tri vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar i gjodezisë me pesë vite përvojë pune pas diplomimit dhe te jete i Licensuar si gjeodet. Kërkesa3 -Pajisjet ne Emër dispozicion te OE me të cilat do të kryhen punimet. Minimumi i pajisjeve për këtë projekt është sipas listes ne ANEKS 6 te dosjes se tenderit. Kërkesa4 - OE duhet te jete i certifikuar me ISO 39001 2012, ISO 18001 2007, ISO 9001 2015, ISO 14001 2015. Kërkesa5 - OE duhet te jete i licencuar për prodhimin e bazës se asfaltit ose te kete mareveshje me ndonje OE te licensuar. Kërkesa6.OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes zhavorr ose te kete mareveshje me ndonje OE te licensuar.	**Miniera dhe Minerale (nese ka mareveshje me OE te licensuar duhet te prezentoje edhe mareveshjen). - Autoriteti kontraktues mund të bëjë verifikimin e çdo dokumenti si dhe inspektimin e kapaciteteve teknike profesionale të gjithë operatorëve ekonomikë tenderues për qëllime të verifikimit. Nëse operatori ekonomik ka paraqitur të dhëna të rrejshme automatikisht do të eliminohet nga vlerësimi dhe oferta e tij do të konsiderohet si ofertë e papërgjegjshme.**

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët ekonomik	Vendi	Çmimi/€	Vërejtje
1.	"Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.T VEHA ; € EURO-GROUP SH. P.K.,	Suhareke	479256,94€	JO
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.T. Bamirs ; EUROFAMIS SH.A., L."	Suharekë	598989,00€	JO
3.	"N.P.T. "Vëllezërit Hoxha",	Samadrexhë	516725,64 €	JO
4.	"Grup i Operatorëve Ekonomik Victoria Invest shpk; N.P.,,Victoria Invest International Sh.p.k	Shqiperi	604527,45 €	JO
5.	"Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.T. Etniku ; KAG - Asphalt Company SH.P.K., ,"	Suharekë	628713,80 €	JO
6.	"SEFERI-CO" SH.P.K.,	Suharekë	642194,92 €	JO
7.	"Grup i Operatorëve Ekonomik AM GROUP SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; Mirusha Company Sh.p.k; N.N.SH. ARDI,	Suharekë	577201,73 €	JO
8.	"FLORI"SH.P.K., ,	Suhareke	446119,18 €	JO
9.	"Grup i Operatorëve Ekonomik: N.N.T." Burimi "; " FAM - ing " SH.P.K.	Malishevë	587784,02 €	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Labinot Bytyçi – Kryetar i komisionit
- Liridona Asllanaj – Anëtar i komisionit
- Arsim Rexhepaj – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.N.T "ETNIKU"- Suhareke, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Asfaltimi i rruges qe lidhe fshatin Ngucat (Rruga BashkimGashi)-Lagjja Zekolli, Suhareke", me nr.prok: 624-19-6384-5-1-1 inicivar nga AK – "KK Suhareke"

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

1 Komisioni pasi vlersoi ofertat konkuruese propozoi per kontratë oferten e pergjegjshme me çmim me te ulet NNT VEHA

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues:

Nr.	Emri i operatorëve ekonomik që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm	Vendi	Çmimi
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.T VEHA ; € EURO-GROUP SH. P.K.,	Suhareke	479.256,94€
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik AM GROUP SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; Mirusha Company Sh.p.k; N.N.SH. ARDI,	Suhareke	577.201,73€
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.T. Bamirs ; EUROFAMIS SH.A.,	Suhareke	598.989,00€
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik Victoria Invest shpk; N.P.,,Victoria Invest International Sh.p.k.,	Shqiperi	604.527,45€
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.T. Etniku ; KAG - Asphalt Company SH.P.K.,	Suhareke	628.713,80

Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardh në përfundim se "Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.T VEHA; € EURO-GROUP SH. P.K." është i përgjegjshëm dhe të njëjtin e kanë rekomanduar për kontratë, me çmim prej: 479.256,94€.
Rekomandimi i komisionit vlerësues është aprovuar nga Menaxheri i prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "N.N.T. Etniku " **- Suharekë**

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë i OE ankues është se Veha Group është i papërgjegjshëm, sepse në FDT është kërkuar Inxhinier i dip, i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose master drejtimi konstruktivë, me se paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit dhe të jetë i certifikuar me IWS ose ekuivalente, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi se inxhinieri i ndërtimtarisë është i certifkuar me IWS.
Ju sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë ka oftuar një lloj çertifikate vendore e lëshuar nga konpani private e cila nuk është sipas kerkesës së AK-së sepse kjo licencë nuk është çertifikatë e njohur ndërkmbëtarisht.

Kërkesë e AK-së ka qenë: **Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktive ose master drejtimi konstruktive, te jetë i certifikuar me IWS ose ekuvalente**. Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne kërkesën e AK-së qe ka qenë certifikata IWS ose ekujvalente sqaron se OE i rekomanduar për kontrat plotëson këtë kërkesë te AK-ës.
Gjithashtu eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin ne oferten e OE të rekomanduar për kontrat sqaron se inxhinieri i ndertimtarisë z.Halil Bytyqi është i certifikuar nga kompania Weld Kos Prishtinë si saldues ku ka të bashkangjitur certifikaten me nr.05/2019 Aftesia profesionale e salduesit.... Ku duke u bazuar ne kërkesat e AK-së kjo certifika mund të llogaritet si ekujvalente. Prandaj duke u bazuar në sqarimet më lartë del se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Marreveshja mes OE të rekomanduar për kontratë me "Celi AG " nuk specifikohet për të cilin projekt, ndërsa Ngarkuesi 24 ton DUD nuk shihet fare dhe dyshojmë se nuk është ne emër të Euro Bag, prej të cilit është blerë kjo pajisje, prandaj kërkojmë të vertetohet ky fakt.

Eksperti shqyrtues sa i perket kësaj pike ankimore konstaton se marrveshja mbi shfrytezimin e makineris nuk specifikon titullin e projektit , por duke u bazuarë në kërkesën e AK-së siq ka qenë: **Dëshmia3 – Librezat kopje të pajisjeve ose Dokumentin doganor, kontratat faturat e blerjes së pajisjeve apo marëveshjet për shfrytëzimin e pajisjeve. Ne rastet kur OE ofron kontrata fatura te blerjes se pajisjeve apo mareveshjeve per shfrytezimin e tyre, pajisjet duhet te deshmohen me kopjen e librezave ose dokumentin doganor (DUD).** Eksperti shqyrtues sqaron së kërkesë e AK-së nuk ka qenë që marrveshja të jetë në emer të këtij projekti, ndersa sa i përket DUD-it doganor në këtë dokument nuk mund të shihen asnjë nga të dhënat. Bazuar ne sqarimet më lart del se ky pretendim ankimor është pjeserisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

2. Grejderi marrëveshja me Hidrotern data 06.04.2018 nuk specifikohet për të cilin projekt i duhet
3. Marrëveshja me Deferi-CO nuk specifikohet për cilin projekt.
4. Marrëveshja me Labi Petroll nuk specifikohet për cilin projekt

Eksperti shqyrtues duke u bazuarë në kërkesat e AK-së konstaton se kërkes e AK-së nuk ka qenë qe marrveshjet të jen në emër te këtij projekti dhe si i till ky pretendim ankimor nuk qendron.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Marrëveshja e OE N.N.T "Veha " për shfrytëzim të pajisjeve është me konpaninë Seferi CO. Ndërsa në DUD-a doganor dhe në dëshmi tjera figurojmë së këto pajisje janë në emer të I Seferit, të cilat kompani janë të ndara dhe funksionojnë në menyrë të pavarur, kurse nuk është ofruar asnjë dëshmi se cilat pajisje i ka në pronësi SEFERI-CO.
Gjithashtu Seferi-CO është pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, prandaj për këtë arsye duhet të shpallet i papergjegjshëm nga ana e autoritetit kontraktues, OE i rekomanduar për kontratë dhe OE Seferi Co.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin e ofruar në oferten e OE të rekomanduar për kontratë ku marrveshja ne mes te OE N.N.T "Veha "për shfrytëzim të pajisjeve është me konpaninë Seferi CO ndersa DUD-at doganor figuronjn se këto pajiseje jan në emër te I Seferi sh.p.k, ne oferten e OE të rekomanduar për kontratë ka të bashkangjitur nje kontratë për teansferin /bartjen (e pjesëshëm të mallit dhe mjeteve themelore) nga " I seferi " sh.p.k ne biznesin "Seferi-co" sh.p.k, mirpo në këtë marrveshje nuk specifikohet qartë se për çfar malli apo cilat mjete bëhet fjalë. Prandaj duke u bazuar ne sqarimet më lartë del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.5

Marrëveshja me 9 Vëllëzerit nuk specifikohet për të cilin projekt dhe nuk është bërë me liderin e konzorciumit VEHA sipas të cilit është obliguar të bëhet marrëveshja si lider i projektit. Anëtari i knzorciumit Euro Group ka nënshkruar marrëveshje për shfrytëzim të mjeteve me kompaninë 9 Vëllezërit, prandaj OE i

rekomanduar për kontratë duhet të shpallet i papergjegjshëm. Gjithashtu nuk shihen qartë DUDA E 9 VËLLEZËRVE

Sa i perket ketij pretendimi ankimor eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin e bashkangjitur në oferten e OE të rekomanduar për kontratë konstaton se në disa nga DUD-at doganor të dhënat jan të palexuara të dhënat jan të pa qarta. Prandaj duke u bazuar në sqarimet më lartë del se ky pretendim ankimor është pjeserisht i bazuar.

Përg**jigje në Pretendimi nr.6**

Pretendimi tjeter i OE ankues është se marrëveshja për asfalt me I.Seferi shpk nuk specifikohet për cilin projekt poashtu edhe marrëveshja me gurëthyesin "Celi Ag" nuk specifikohet për cilin projekt.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin ne lëndë dhe në kërkesat e AK-së sqaron se kërkesë e AK-së ka qenë :

Kërkesa 5 - OE duhet te jete i licencuar për prodhimin e bazës se asfaltit ose te kete mareveshje me ndonje OE te licensuar. Dëshmia5- Kopja e licences se vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale (nese ka mareveshje me OE te licensuar duhet te prezentoje edhe mareveshjen).

Kërkesa6.OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes zhavorr ose te kete mareveshje me ndonje OE te licensuar. Dëshmia 6 - Kopja e licences se vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale (nese ka mareveshje me OE te licensuar duhet te prezentoje edhe mareveshjen).

Prandaj duke u bazuar në kërkesën e AK –së eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e AK-së nuk ka qen qe marrveshja për furnizim me asfalt të jet në emer të këtij projekti. Duke u bazuar në sqarimet me lartë del se ky pretendim ankimor nuk qendron, pasi qe OE i rekomanduar për kontratë ka të bashkangjitur marreveshje per furnizim me te gjitha llojet e asfaltit ku në këtë marrveshje thuhet **citoj**: *Me anë të kësaj marrëveshje palët e lartpërmendura bien dakord që "I.SEFERI" SH.P.K të bëjë furnizimin me Asfalt të nevojshëm për kompaninë N.N.T. VEHA sipas nevojave për realizimin e projekteve të ndryshme*. Po ashtu sa i perket pikes ankimore se Marrëveshja me gurëthyesin "Celi Ag" nuk specifikohet për cilin projekt edhe ky pretendim ankimor nuk qendron pasi qe kerkes e AK-së nuk ka qenë qe marrveshja të jetë në emër te këtij projekti.

Përg**jigje në Pretendimi nr.7**

Pretendimi tjetër i OE ankues është se deklaratat nën betim të dy anëtarëve të konzorciumit nuk janë të nënshkruara me dorë, por duket të jenë të manipuluara përmes skenimit.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin në lëndë sqaron se deklaratat në fjalë jan të nenshkruara dhe të skanuara ndersa sa i përket manipulimit përmes skenimit eksperti shqyrtues nuk mund ta vertetoj këtë gjë.

Përg**jigje në Pretendimi nr.8**

Ndërsa tek kontrata e prezantuar me kompaninë " **Fati im** ", dyshojmë se nuk është e realizuar pasi që nuk ka asnjë transaksion bankar në lidhje me këtë projekt.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e AK-së dhe dokumentacionin në lëndë sqaron se kërkesat e AK-së kan qenë:

Kërkesa1- Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme, ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne vlerën prej se paku 1.000.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve.	**Dëshmia1 -Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjajshme të realizuara ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, dhe dëshmitë e përfundimit Referencat ose procesverbaliet e pranimit teknik.**

Bazuarë në kërkesatë e AK-së eksperti shqyrtues konstaton se kërkes e AK-ës ka qen te deshmohet me referenc ose proces verbal të pranimit teknik. Andaj nga sqarimet më lartë del se ky pretendim ankimor nuk qendron dhe se OE i rekomanduar për kontrat ka sjellur një letër referencë të leshuar nga kompania "FATI IM " ku kjo leter referenc është e nenshkruar dhe e vulosur nga kompania në fjalë.

Përg**jigje në Pretendimi nr.9**

Pretendimi tjeter i OE ankues është se kontrata me Limak nuk përputhen datat anglisht në pikën 2 shkruan data 01.10.2018, ndërsa turqisht pika 2 e kontratës shkruan data 01.10.2013 dhe në referencë nuk shkruan që punimet kanë përfunduar. Këto punime siç jemi në dijeni akoma vazhdojnë (https://www.facebook.com/SHPK-Eurogroup-349257248532921/)

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne kontraten e bashkangjitur në oferten e Grup të Operatorëve Ekonomik N.N.T VEHA; € EURO-GROUP SH. P.K.,sqaron se kontrata shtesë qe është lidhur me Limak dhe antarin e konzerciumit € Euro Grup sh.p.k është bërë me 01. Prill 2019 ku të njejten datë ka edhe ne gjuhen turke, sa i perket pikes 2 të kësaj kontrate datat dhe muaji jan të njeta citoj:01.10. 2018 ne gjuhen anglez ndersa ne gjuhen turke 10.10.2013 ndersa viti është i ndryshem ku mund të jetë nje gabim teknik.

Ndersa sa i perket pikes se në referenc nuk shkruan se ka perfunduar punimet, eksperti shqyrtues sqaron se ne paragrafin e tretë të kësaj reference shkruan **citoj**: *Ne konsiderojmë se Euro Group sh.p.k kanë kryer në përputhje me detyrimet kontraktuale me një nivel të lartë të cilësisë dhe sipas standardeve teknike*. Nga kjo qe u tha me lartë del se në këtë referenc nuk ceket qartë se a kan perfunduar në tersi punimet apo thuhet vetem për pjesen e kryer deri me tani. Prandaj duke u bazuar në sqarimet më lartë del se ky pretendim ankimor është pjeserisht i bazuar.

Përg**jigje në Pretendimi nr.10**

Pretendimi tjeter i OE ankues është se OE i rekomanduar për kontratë ka të bashkangjitur edhe një kontratë e cila nuk mund të mirret si valide sepse është në vazhdim që titulohet "Ndërrimi i lagjes"SOFALIA HILLS" sipas Parimit çelësat në dorë".

Eksperti shqyrtues sa i perket kësaj pike ankimore sqaron se në listen e kontratave të realizuara kjo kontrat thuhet se është 70% e perfunduar dhe vazhdon ënde. Prandaj nga sqarimet me lart del se ky pretendim ankimor qendron.

Përg**jigje në Pretendimi nr.11**

Pretendimi jeter i OE ankues është se operatori ekonomik "**Am Group Shpk** " është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar deklaratën për specifikime teknike, e cila ka qenë kërkesë nga ana e autoritetit kontraktues.

Po ashtu ky OE nuk ka ofruar stafin sipas kërkesave të FDT-së dhe nuk posedon konrata dhe referenca e kerkuara nga ana e AK-së. Gjithashtu OE i mungon edhe certifikata IWS per inxhinierin e ndertimtaris.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin në lënd sqaron se OE në fjalë

- Deklarata për specifikime tekinik nuk ka qen kërkes e AK-së, kjo pikë ankimore është e pa bazuar.
- Gjithashtu OE i mungon certifikata IWS per inxhinierin e ndertimtaris konstruktive, inxhinieri z. Ibrahim Selishta ka nje certifikat qe ka ndjekur me sukses kursin si Specialist Ndërkombëtar i Saldimit (IWS). Nga kjo qe u tha me lart del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Përg**jigje në Pretendimi nr.12**

Pretendimi tjeter i OE ankues është se operatori ekonomik "NNT Burimi Fami-ing", është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar deklaratën për specifikime teknike, Menaxheri Inxh. Infrastrukt.dëshmia për 3 vitet përvojë pune i mungon, gjithashtu nuk ka IWS të çertifikuar dhe është e qëndrueshme arsyeja e eliminimit nga ana e autoritetit kontraktues për këtë OE, sepse i mungon edhe dëshmia për sigurimin e tenderit ashtu siç është kërkuar në FDT dhe nuk ka ofruar dëshmi për pikën " Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Stafi profesional siç është kërkuar në FDT" Pra ne pajtohemi me arsyen e AK-së për eliminimin e këtij operatori ekonomik.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e AK-së dhe dokumentascionin në lëndë sqaron:

- Deklarata për specifikime tekinik nuk ka qen kërkes e AK-së, kjo pikë ankimore është e pa bazuar.
- I mungojn deshmi per piken Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale/ Stafi profesional siq eshte kerkuar me FDT. Kjo pikë ankimore është e bazuar.
- Sigurija e tenderit është e bashkangjitur ne oferten e "NNT Burimi" ku përmban të gjitha pikat sipas DT, kjo pikë ankimore është e pa bazuar.

Përg**jigje në Pretendimi nr.13**

Pretendimi tjeter i OE ankues është se operatori ekonomik "NTP Bamirs Euro Famis", është i papërgjegjshëm sepse nuk ka oftuar deklarata për specifikime teknike.

Gjithashtu ky OE nuk posedon IWS për Inxhinierin e Ndërimit Konstruktiv gjë që është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktues në FDT tek kërkesat mbi mundësitë teknike/ose profesionale. Pra ky operator duhet shpallur i papërgjegjshëm ashtu siç e cekëm me lartë sepse nuk i plotëson kërkesat e lartëcekura.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e AK-së dhe dokumentacionin në lëndë konsatonse:

5. Deklarata për specifikime tekinik nuk ka qen kërkes e AK-së, kjo pikë ankimore është e pa bazuar.
6. Inxhinierin e Ndërimit Konstruktiv posedon certifikaten si Mbikëqyrës i Saldimit sipas ISO 14371 që mund te llogaritet si ekujvalente me certifika IWS, prandaj duke u bazuar në kerkesen e AK-së qe ka

qen certifikata IWS ose ekujvalente OE në fjalë plotëson këtë kërkesë dhe si i tillë ky pretendim ankimor është pjeserish ti bazuar

Përgjigje në **Pretendimi nr.14**

Pretendimi tjeter i OE ankues është se Operatori ekonomik " **Victoria Invest Shpk** ". Gjithashtu edhe ky operator ekonomik duhet shpallur i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar deklaratë për specifikime teknike. Po ashtu nuk posedon edhe IWS të certifikatat për Inxhinierin e Ndërtimit Konstruktiv tek Kërkesat mbi mundësitë teknike/ose profesionale.

Gjithashtu operatorit në fjalë i mungon edhe fleta e dytë e sigurimit të tenderit. Pra nuk i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë dhe duhet shpallur si OE i papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e AK-së dhe dokumentacionin në lëndë konsaton se:

- Deklarata për specifikime tekinik nuk ka qen kërkes e AK-së, kjo pikë ankimore është e pa bazuar.
- Inxhinierin e Ndërimit Konstruktiv posedon nje certifikat vetem për pjesmarrje në trajnim. Dhe si e tillë kjo pikë ankimor është e bazuar.
- I mungon edhe fleta e dytë e sigurimit të tenderit. Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin në lënd sqaron se OE në fjalë ka të bashkangjitur sigurimin e tenderit sipas kerkesave në aneksin 4 të DT. Dhe si e till kjo pik ankimore nuk qendron.

Përgjigje në **Pretendimi nr.15**

Pretendimi tjeter i OE ankues është se edhe OE "**Seferi Co Shpk**" është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar sigurimin e tenderit, po ashtu është e qëndrueshme edhe arsyeja e eliminimit të këtij OE nga ana e AK-së sepse nuk ka ofruar dëshmi edhe për pikën Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale/Stafi profesional siç është kërkuar mbi FDT dhe po ashtu i mungojnë edhe dëshmitë e kërkuara në FDT për pajisje.
Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin në oferten e OE "**Seferi Co Shpk**" konstaton se

- Mungon sigurija e tenderit dhe si e till kjo pikë ankimore është e bazuar.
- Dëshmitë e kërkuara në FDT për pajisje disa prej tyre mongojn. Dhe si e till kjo pikë ankimore është e bazuar.
- Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale/Stafi profesional nuk ploteson kërkeseën e AK-së. Dhe si e till kjo pikë ankimore është e bazuar.

Përgjigje në **Pretendimi nr.16**

Pretendimi tjeter i OE ankues është se OE " **Vëllezërit Hoxha**" është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar sigurimin e tenderit, po ashtu është e qëndrueshme edhe arsyeja e eliminimit të këtij OE nga ana e AK-së për shkak se, nuk i ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale/Stafi profesional siç është kërkuar me FDT.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin në oferten e OE " **Vëllezërit Hoxha**"konstaton se

- Mungon sigurija e tenderit dhe si e till kjo pikë ankimore është e bazuar.
- Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale/Stafi profesional nuk ploteson kërkeseën e AK-së. Dhe si e till kjo pikë ankimore është e bazuar.

Përgjigje në **Pretendimi nr.17**

Pretendimi tjeter i OE ankues është se edhe OE " **Flori Shpk**", është i papërgjegjshëm sepse i mungon dëshmia për sigurimin e tenderit siç është kërkuar në FDT dhe nuk ka ofruar dëshmi për pikën.

Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale/Stafi profesional siç është kërkuar në FDT dhe po ashtu i mungojnë dëshmitë e kërkuara me FDT për pajisje. Pra janë të qëndrueshme arsyet e eliminimit nga ana e AK-së.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin në oferten e OE " **Flori Shpk**", konstaton se

7. Mungon sigurija e tenderit dhe si e till kjo pikë ankimore është e bazuar.
8. Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale/Stafi profesional nuk ploteson kërkeseën e AK-së. Dhe si e till kjo pikë ankimore është e bazuar.
9. Dëshmitë e kërkuara ne FDT për pajisje nuk plotësojnë kërkesën e AK-së. Dhe si e tillë kjo pikë ankimore është e bazuar.

Përgjigje në **Pretendimi nr.18**

Pretendimi tjeter i OE ankues është se në vendimin e AK-së të dt. 21.10.2019 për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsye faktike dhe ligjore për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim por vetëm e ka cilësuar si të pa bazuar.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne venimin e AK-së për refuzimin e kërkeses për rishqyrtim sqaron se në këte vendim AK nuk ka dhënë asnje arsyetim rreth refuzimit si te pa bazuar të kërkesës se paraqitue nga ana e OE ankues. Prandaj duke u bazuar ne nenin Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve paragrafi 12. thotë:

12.Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.

Bazuar ne sqarimet më larë del se ky pretendim ankimor qendron.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.